



Planuar / Doretuar Primijsa/Prodato Received/Deliverty	24.05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org:Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKUPITSHCK	3011/2022		117	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.355/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.355/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjaksme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.05.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.355/2022 e datës 12.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Njoftimi me numër Prot:0093 i lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 01.02.2022.
- III. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës që t'i lëshojë ankuesit akt emërimit për emërim të përhershëm (pa afat të caktuar) në Shërbimin Korrektues të Kosovës.
- IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Lipjan", është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues, se të njëjtit i përfundon kontrata e punës me datë 27.05.2022.

Ankuesi, kundër njoftimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues, ka parashtruar ankesë me datë 12.04.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është regjistruar me numër protokolli: 2021/2022 me pretendimet se sipas nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me akt emërim dhe përveç kur parashikohet ndryshe me ligj është e përhershme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.04.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli, me datë 26.04.2022 me numër protokolli 2415/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës si dhe me datë 23.05.2021 ka pranuar provat shtesë sipas kërkesës. Po ashtu Këshilli me qëllim të vendosjes meritore, ankuesit i ka kërkuar që të bëjë plotësim e ankesës me dokumentet e nevojshme të kualifikimeve profesionale të cilat i ka pranuar në cilësi të provave shtesë me datë 23.05.2022 dhe 24.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 12.04.2022 me numër protokolli 2021/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 12.04.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kontratën e punës së ankuesit të datës 28.04.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.04.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 26.04.2022 me numër protokolli:2415/2022; Njoftimin për përzgjedhje të kandidatit i datës 18.05.2012; Njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 01.02.2022 me numër:0093/2022; Njoftimin për deklarinimin e statusit të zyrtarëve publikë; Diplomën e ankuesit të datës 22.02.2011; Diplomën e datës 24.07.2022 e lëshuar nga Universiteti i Sarajevës me numër:234-P/10; Vërtetimin e datës 20.12.2010; Çertifikatën e ankuesit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan e datës 23.05.2022; E-mailin e datës 23.05.2022 dërguar nga Menaxheri i Personelit të SHKK për Këshillin; E-mailin e ankuesit të datës 24.05.2022; Çertifikatën e periudhës kohore 30 shtator-02 tetor 2015 lëshuar nga IRZ dhe JCI dhe KCS; Çertifikatën e datës 26.03.2015 lëshuar nga IKAP; Çertifikatën e datës 19.06.2015 lëshuar nga IKAP; Çertifikatën e datës 17.08.2012 lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Lejen e sigurisë lëshuar nga Agjencia e Kosovës; Medaljen e lëshuar me datë 10.12.2008 nga TMK-Shtabi i Përgjithshëm; Vërtetimin e datës 12.06.2010; Çertifikatën e periudhës kohore 1-2 nëntor 2016 lëshuar nga IRZ dhe JCI dhe KCS; Çertifikatën e datës 08.10.2015 lëshuar nga EULEX; Çertifikatën e datës 29.10.2013 lëshuar nga London School of English; Çertifikatën e lëshuar nga Tëining e periudhës kohore shkurt 2016-nëntor 2017; Çertifikatën e lëshuar nga Cisco e datës 24.12.2010; Çertifikatën e lëshuar nga PBC; Çertifikatën e datës 20.10.2017; Çertifikatën e datës 03.08.2015; Çertifikatën e lëshuar USDJ në programin ICITIAP e periudhës kohore 27-29 mars 2017; Çertifikatën e datës 16.02.2016 lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Çertifikatën e datës 14.06.2012 lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Vërtetimin e datës 08.09.2017 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme; Vendimin e datës 16.09.2016 lëshuar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë; Vërtetimin e datës 09.07.2008 lëshuar nga

TMK Zona e 6-të; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020; Çertifikatën e lëshuar nga EULEX e datës së fundit 01.11.2019; Çertifikatën e lëshuar nga United States of America Department of State të datës 10.05.2019; Çertifikatën e datës 20.05.2022; Çertifikatën e datës 10.06.2021; Mirënjohje e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë për rezultatet e arritura për vitin 2019 në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi marrëdhënien e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Lipjan" e ka themeluar mbi bazën e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe Ligji Nr. 03/1-212 të Punës, fillimisht e njëjta marrëdhënie e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës e kishte themeluar në vitin 2012 sipas njoftimit zyrtar për përzgjedhje të datës 18.05.2012 lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa sipas kontratës së fundit të ankuesit të datës 28.04.2017 të njëjtit i përfundon marrëdhënien e punës me datë 27.05.2022.

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënien e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për kategorinë e nëpunësve civil dhe ligjit të veçantë për shërbimin korrektues të përcaktuar sipas nenit 4 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku caktohet se: "2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve".

Kolegji, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil 1. Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme:..., zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës..... Marrëdhënien e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale, dhe po ashtu me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat kalimtare të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik neni 83 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1; 2.2 dhe 2.3 përcaktohet se: "Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mban një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji ; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë"", ndërsa në bazë të shkresave të lëndës

respektivisht njoftimit zyrtar për përzgjedhje të datës 18.05.2012 lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe kontratës së fundit të datës 28.04.2017, Kolegji ka konstatuar se ankuesi përpara se të hyj në fuqi me datë 09.07.2020 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i ka pasur të paktën tetë (8) vite përvojë punë, nga rrjedh se ankuesi i ka plotësuar edhe kriteret e përcaktuara me nenin 83 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1; 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ndërlidhur edhe me kriteret e përcaktuara si në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku është përcaktuar se: *"1.Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji dhe 2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 2.2. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji"*, pasi që ankuesi në bazë të Certifikatës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dega Lipjan e datës 23.05.2022 me numër:1855/22 dëshmon se i njëjti nuk është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë dhe as nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij, po ashtu sipas konfirmimit zyrtarë nëpërmjet e-mailit të datës 23.05.2022 dërguar në Këshill nga Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konfirmohet se ankuesi nuk ka masë disiplinore aktive, ndërsa sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 15.01.2021 është vlerësuar me notën e përgjithshme "shumë mirë 4.0" dhe Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 20.12.2019 është vlerësuar me notën e përgjithshme "shumë mirë 4.36" nga dëshmohet fakti se ankuesi ka qenë i vlerësuar së paku për dy (2) vitet e fundit me notë të përgjithshme përtej kriterit të kërkuar, andaj si përfundim sikurse në arsyetim të cekur edhe me lartë, Kolegji ka gjetur se ankuesi e plotëson kriterin e përcaktuar si në nenin 83 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik.

Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi bazën e të cilit ankuesja e ka lidhur marrëdhënien e punës i ka përcaktuar kriteret e rekrutimit për pozitën Drejtorit dhe Zv/Drejtorit të institucionit korrektues në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës si në nenin 217 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1; 4.2; 4.3; 4.4 dhe 4.5 ku përcaktohet se: *"Detyrën e drejtorit të institucionit korrektues mund ta ushtroj personi (kandidati) i cili i plotëson kushtet në vijim: 4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 4.2. të ketë përgatitje universitare; 4.3. të ketë gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku tri (3) vite përvojë pune në pozita udhëheqëse; 4.4. të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike; 4.5. të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për veprë penale"* ndërlidhur me paragrafin 7 të nenit 217 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"7.Institucionet korrektuese mund të kenë edhe zëvendës drejtorët të cilët emërohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese"*, po ashtu Kolegji ka analizuar edhe Rregullore QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me strukturën organizative të Shërbimit Korrektues ka përcaktuar si në nenin 29 paragrafin 3: *"3. Organet lokale të Shërbimit Korrektues të Kosovës, organizimi i brendshëm i të cilave trajtohet në nënkre të kësaj Rregullore, janë: 3.1. Qendra Korrektuese në Dubravë; 3.2. Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan; 3.3. Qendra Korrektuese në Smrekonicë; 3.4. Qendra e Paraburgimit në Prishtinë; 3.5. Qendra e Paraburgimit në Lipjan; 3.6. Qendra e Paraburgimit në Gjilan; 3.7. Qendra e Paraburgimit në Pejë; 3.8. Qendra e Paraburgimit në Prizren; 3.9. Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë; 3.10. Burgu i Sigurisë së Lartë"* si dhe referuar konkursit publik të shpallur nga Shërbimi Korrektues me datë 07.02.2022 dhe numër Reference RN00008066 për pozitën *"Zëvendësdrejtor i Qendrës Korrektuese- Qendra Korrektuese në*

*Smrekonicë*“ evidentohet fakti se pozita e Zëvendës Drejtorit të Qendrës Korrektues është pozitë ekuivalente me pozitën të cilën e ushtron ankuesi, ndërsa nga Shërbimi Korrektues i Kosovës është përcaktuar si pozitë e kategorisë Drejtues i Ulët 2, të cilin e konfirmon edhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes e-mailit të datës 22.03.2022 (lidhur me ankesën A.nr.114/2022 e shqyrtuar dhe vendosur në Këshill) , citoj: *“Lidhur me pozitën e Drejtor dhe Zëvendës Drejtor në Institucione Korrektuese, klasifikimi është bërë nga Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publik, në kuptim të Ligji nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, pozita e Drejtorit është klasifikuar pozite e mesme drejtuese, ndërsa pozita e zëvendës drejtorit pozite e ulët drejtuese, te bashkangjitur gjeni dy konkurset e shpallura”.*

Kolegji në kuptim të kësaj ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku në SHTOJCA NR. 1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovës, ndërlidhur me Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ulët 2 lidhur me kërkesat dhe kushte formale që duhet të plotësojë një kandidat-nëpunës civil për ushtrimin e kësaj detyre përcaktohet si në vijim: *“Kërkesat e Përgjithshme Formale: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale”*, ndërsa ankuesi në bazë të provave të ofruara nga institucioni punëdhënës dëshmohet se sipas Diplomës të datës 22.02.2011 me numër:084/11 i njëjti me datë 02.06.2010 i ka përfunduar studimet në Fakultetin e Kriminalistikës të Universitetit AAB dhe ka marr titullin Bachelori i Kriminalistikës me gjithsejtë 180 kredi, po ashtu sipas diplomës të datës 05.02.2013 me numër:060/13 i njëjti me datë 25.01.2013 i ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit AAB dhe ka marr titullin LLB në Juridik me gjithsejtë 240 kredi-ECTS, po ashtu posedon Çertifikatën e periudhës kohore prej datës 30 shtator- 02 tetor 2015 lëshuar nga IRZ dhe JCI dhe KCS; Çertifikatën e datës 26.03.2015 lëshuar nga IKAP; Çertifikatën e datës 19.06.2015 lëshuar nga IKAP; Çertifikatën e datës 17.08.2012 lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Çertifikatën e periudhës kohore 1-2 nëntor 2016 lëshuar nga IRZ dhe JCI dhe KCS; Çertifikatën e datës 08.10.2015 lëshuar nga EULEX; Çertifikatën e datës 29.10.2013 lëshuar nga London School of English; Çertifikatën e lëshuar nga Tëning e periudhës kohore shkurt 2016-nëntor 2017; Çertifikatën e lëshuar nga Cisco e datës 24.12.2010; Çertifikatën e lëshuar nga PBC; Çertifikatën e datës 20.10.2017; Çertifikatën e datës 03.08.2015; Çertifikatën e lëshuar USDJ në programin ICITIAP e periudhës kohore 27-29 mars 2017; Çertifikatën e datës 16.02.2016 lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Çertifikatën e datës 14.06.2012 lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Vërtetimin e datës 08.09.2017 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Çertifikatën e lëshuar nga EULEX e datës së fundit 01.11.2019; Çertifikatën e lëshuar nga United States of America Department of State të datës 10.05.2019; Çertifikatën e datës 20.05.2022; Çertifikatën e datës 10.06.2021; Mirënjohje e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë për rezultatet e arritura për vitin 2019 në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe mbi këtë bazë Kolegji ka gjetur se ankuesi i plotëson kriteret e përcaktuara si në nenin 83 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik të ndërlidhura me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik.

Kolegji po ashtu ka gjetur se, sipas njoftimit mbi deklarinimin e statusit të zyrtarëve publik i datës 16.06.2021 i nënshkruar nga menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ka bërë shqyrtimin, verifikimin dhe deklarinimin e statusit të zyrtarëve publik dhe se pozita të cilën e ushtron ankuesi “Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Lipjan” është klasifikuar pozitë në shërbimin civil si në pikën 2. *“Zv. Drejtor i Institucionit Korrektues-*

*Nëpunës i Shërbimit Civil*", nga rrjedh se institucioni punëdhënës i ankuesit e ka përmbushur njërin nga obligimet ligjore që dalin nga dispozitat transitore të përcaktuara si në nenin 83 paragrafi 16 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklaramit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative"*.

Andaj, pas peshimit të provave të lëndës një nga një, veç e veç dhe të gjitha së bashku në tërsi, prova këto të ofruara nga palët në procedurë, si dhe pas analizimit të diapozitiva ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Rregullore QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Rregullores Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe pranimit të komenteve sqaruese nga institucioni punëdhënës, Kolegji ka ardhur në përfundim se ankuesi i plotëson të gjitha kriteret dhe kushtet e përgjithshme për pozitën që ushtron sikurse është cekur në pjesën e sipërme të arsyetimit, si dhe i ka plotësuar të gjitha parakushtet e tjera të përcaktuara me dispozitat transitore të përcaktuara në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa Shërbimi Korrektues i Kosovës sipas detyrës zyrtare ka qenë i obliguar të veprojë sipas dispozitave transitore të përcaktuara në nenin 83 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1; 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase i njëjti i ka plotësuar edhe kriteret dhe parakushtet e përcaktuara edhe sipas nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj mbi këtë bazë si dhe të gjeturave të specifikuara si më lartë në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar ndërsa Shërbimi Korrektues i Kosovës është i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sikurse përcaktohet: *"Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar)"* njëherit ankuesit kontratën e punës duhet t'ia shndërrojë në akt emërim të përhershëm (pa afat të caktuar) në Shërbimin Civil, ngase ankuesit këtë të drejtë ia ka garantuar ligji material në momentin e hyrjes në fuqi me datë 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 dhe se institucioni ka qenë i obliguar të ndërmarrë të gjitha veprimet sipas detyrës zyrtare me qëllim të përmbushjes obligimeve ligjore në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ndërlidhur me obligimin që Shërbimi Korrektues i Kosovës ankuesit t'ia shndërrojë kontratën në akt emërim të përhershëm, me qëllim të respektimit të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me statusin e veçantë të nëpunësve civil të punësuar në Shërbimi Korrektues i Kosovës, Kolegji ka kërkuar sqarime shtesë nga Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore si në vijim, citoj korrespondencën: *"Nëse është e mundur të na e konfirmoni si në vijim: "Te rasti i shpalljes së konkursit për pozitën Zëvendës Drejtor i Qendrës Korrektuese në Smrekovnicë dhe konkursit për pozitën Drejtor i Qendrës Korrektuese në Smrekovnicë, pasi që të përfundojnë procedurat e rekrutimit: A do ta themelojnë marrëdhënien e punës të përzgjedhurit për kohë të caktuar, apo për kohë të pacaktuar (përhershme) -me akt emërim", ndërsa përgjigja e dhënë është si në vijim, citoj: "Me hyrjen në fuqi të Ligjit për zyrtar publik, pozitat e drejtor dhe zëvendës drejtor emërohen sipas procedurave të konkurrimit bazuar në këtë ligj, prandaj në kuptim të LZP pozitat e shpallura emërohen me akt emërim me afat të pacaktuar", andaj mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se shndërrimi i kontratës së ankueses në akt emërim të përhershëm nuk i cenon dispozitat e lartcekura të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me statusin e veçantë të nëpunësve civil të punësuar në Shërbimi Korrektues i Kosovës, mirëpo institucioni e ruan të drejtën duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1.**

kushite të veçanta apo shitesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve” dhe në çdo rast nëse e vlerëson se ankuesi nuk mundet ta ushtrojë me afat të përhershëm pozitën të cilën e mban aktualisht “Zëvendës Drejtoreshë e Qendrës së Paraburgimit në Lipjan”, mund të veprojë konform ligjit të tyre të veçantë, mirëpo çdo herë duke u kujdesur për respektimin e parimeve themelore për shërbimin civil të përcaktuara si në nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të provave të lëndës si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka konstatuar se njoftimi i datës 01.02.2022 me numër:0093 lëshuar nga Menaxheri i Shërbimit Korrektues nuk i përmbush detyrimet ligjore të institucionit dhe nuk ka qenë në frymën e ligjit material, dhe si i tillë akti është i paligjshëm siç përcaktohet edhe nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material”, ngase institucioni punëdhënës i ka zbatuar gabimisht apo nuk i ka zbatuar fare dispozitat kalimtare të përcaktuara në nenin 83 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe si i tillë njoftimi datës 01.02.2022 shfuqizohet dhe i njëjti duhet të largohet nga dosja personale e ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenin 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.355/2022**

**Flakron GASHI**

  
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.